

Datë 04.07.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Transporti i Lëndës Drusore të Mbetur të Paevaduar në Ngastrat e Ekonomisë Pyjore Fag”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
77211200-4 Transporti i trungjeve në pyll

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 2.757.369 (dymilion e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lek **pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; me vlere : Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës : 55.147,38 (pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e shtatë presje tridhjetë e tetë) lekë pa Tvsh, të lëshuar në formën e garancisë bankare, nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse ose pagese e kryer ne numrin e llogarise se Autoritetit Kontraktor.*

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”*

*“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”*

## 2. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

**2.1.1** -Operatori ekonomik/ofertuesi duhet te paraqese Licencen Profesionale te shoqerise duke deshmuar qe zoteron keto kategori lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates:

Kodi III-7 A “shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotat”  
lëshuar nga  
QKL

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të pikës 4 të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në nenin 41, pika 4, gërma, (a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku specifikisht përcaktohet:

*4.Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Gjithashtu ky kriter është vendosur në mbështetje të ligjit specifik dhe akteve nënligjore në zbatim të tij respektivisht në Ligjin 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, i ndryshuar VKM nr.438 datë 08/06/2016”, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e prodhimeve të tjera pyjore”, si dhe udhëzimit nr.2 datë 03/03/2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor, me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”

Në mbështetje të VKM-së Nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuara, “Veprimtaria e nënkategorisë”, kriteri për licencën e lëshuar nga QKL me kodin III.7. A është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertojë të jete i pajisur me licencën e mesipërme, e nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit, gje e cila krijon bindjen dhe sigurinë të Autoriteti Kontraktor që ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës. Në seksionin “Kategoria III.7. A “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotat”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.7.A”, të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar. Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për të ndërhyrë dhe kryer aktivitet në zonën pyjore. Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër konstatohet se gjatë kryerjes së shërbimit, referuar edhe parashikimeve të preventivit, paraqitet kryerja e veprimtarisë së transportit të lëndës drusore dhe pastrimit në ekonomi pyjore i cili referuar kuadrin ligjor në fuqi “Për pyjet” duhet të kryhet nga subjekte të licensuara dhe është në përputhje me natyrën e kontratës.

## 2.2 .Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës.

**Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e tregëtimit të karburanteve, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.**

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e thjeshtuar–Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 ”Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, dhe Kreu II ”Kufijtë monetarë” të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 ”Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

*Neni 43*

*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, ne procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

## KREU II

### KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

- a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;
- b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në korrik të vitit 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

**Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.**

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të konfirmuara pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c" të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

## **2.1 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate konkretisht: 551,473 (pesëqind e pesëdhjetë e njuëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa Tvsh .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar

me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

### **2.3.2 Një punësim mesatar i të paktën 8 (tetë) personave, për periudhën e 3 (tre) muajve te fundit Mars 2024 – Maj 2024.**

Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën Mars 2024 – Maj 2024.
- Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Mars 2024 – Maj 2024.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 (c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë transporti i lëndës drusore, ngarkim, shkarkim dhe sistemim dhe stivim procese pune që kryhen me krahe pra me fuqi punëtore është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë fuqi punëtore e vërtetuar kjo me vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore si dhe me listëpagesat ku të vërtetohet numri mesatar i punonjësve. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në sasinë e lëndës drusore që do të transportohet, ngarkohet, shkarkohet dhe stivohet.

**2.3.3** Operatori duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga Administratori i Shoqërisë, Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i profesionit Inxhinier Pyjesh për të cilin duhet të paraqesë: Kontrate pune, Diplome dhe Çertifikatën e lëshuar nga ministria e Turizmit dhe Mjedisit për shërbime në pyje dhe kullota, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4(b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë drejtuesin teknik inxhinier pyjesh për kryerjen e shërbimeve i cili ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen shërbimeve pasi ai është përgjegjës për zbatimin e projektit në përputhje me kushtet teknike. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky inxhinieri është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafin teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me shërbimet që kërkohen të realizohen të cilat janë shërbime në fushën e pyjeve. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, si dhe në mbështetje të pikës 4 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit të kontratës.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamiona, kapaciteti total mbajtës minimumi 7 ton	në pronësi ose me qera	copë	2
2	Organellë ose traktor teknologjik	në pronësi ose me qera	copë	1
3	Motosharre	në pronësi ose me qera	copë	1

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshëm), Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme), Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi si dhetë shoqërohet me aktin e pronesisë së qeradhenesit. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa (ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është transporti i lëndës drusore, të dëshmojnë që kanë, makinerit dhe pajisjet e nevojshme të përcaktuara më sipër me qëllim realizimin të objektit të prokurimit. Ndërkohe specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara në zërat e shërbimit të kërkuara.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet Teknike dhe termat e referencës për procedurën respektive janë hartuar nga komisioni i Përgatitjes së specifikimeve teknike, termat e referencës dhe përllogaritjes së fondit limit i ngritur me urdhër nr.547 me nr.1345/1 prot, datë. 23.05.2024, pjesë përbërëse e strukturës së Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, në përputhje me nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 41, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të Nenit 17 të Ligjit 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, VKM nr.438 datë 08/06/2016”, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e prodhimeve të tjera pyjore”, si dhe udhëzimit nr.2 datë 03/03/2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor, me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”,

Specifikimet Teknike dhe termat e referencës janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

**Shënim:** Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

**Kujdes:** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.